



Tetorë 2008

### Informacioni rreth aktiviteteve të Trupit koordinues (prill-shtatorë 2008)

**Trupi Koordinues i Republikës së Sërbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë publikon raportin e gjashtëmujorit të dytë.** Qëllimi i informimit të partnerëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë është prezantimi i aktiviteteve të Trupit Koordinues në mënyrë të hapur dhe transparente por edhe të nxisë shkëmbimin e informatave dhe përparimin e bashkëpunimit sa më më efikas në përdorimin e resurseve.

Nëse doni të merrni raportet tona, ju lutemi të kontaktoni zyren tonë në [office@kt.sr.gov.yu](mailto:office@kt.sr.gov.yu) ose në tel 011/21 20 906.

Qeveria e Republikës së Sërbisë në shtatorë ka emëruar Milan Marković, ministër i pushtetit lokal për kryetarë të Trupit Koordinues. Kryetari i ri është i vendosur që të vazhdojë reformat e filluara në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me qëllim të integritit të plotë të këtyre komunave në rrjedhat politike, ekonomike dhe shoqërore në Sërbë.

Kryetari i deritashëm i Trupit Koordinues, Rasim Lajiq, ministri për punë dhe qështje sociale, ka bërë përpjekje të mëdha në reformën e Trupit Koordinues që të mos fokusohet vetëm në përmirësimin e infrastrukturës por edhe në zhvillimin ekonomik dhe integritit social.

Aktivitetet më të rëndësishme të Trupit Koordinues në periudhën nga prilli e deri në tetorë të vitit 2008:

Përmirësimi i komunikimit në mes të Qeverisë dhe qeverisjeve lokale dhe prioriteti i punës në periudhën e ardhshme:

- **Kraetari i Trupit Koordinues, Milan Marković, vizitoi komunën e Medvegjës më 6 tetorë** ku bisedoi me kryetarin e komunës së Medvegjës, Slobodan Draskovićin rreth gjendjes dhe problemeve të kësaj komune. Kryetari i Trupit Koordinues paralajmëroi hapjen e paraleles së shkollës së biznesit së Univerzitetit të Beogradit në Medvegjë në afat sa më të shkurtër. „Hapja e këtij institucioni do t'i ndihmojë në zhvillimin e Sërbisë Jugore për arsye se këtu mundë të stujojnë studentët serb nga Medvegja dhe rrethina si dhe shqipëtarët të cilët ligjëratat munden t'i ndjekin në gjuhën e tyre amtare. Studentët të cilët kryejnë këtë paralele do të marrin diplomat e Univerzitetit të Beogradit” ka thënë Milan Marković. Njëra ndër prioritetet tjera të Qeverisë së Republikës së Sërbisë dhe Trupit Koordinues për Sërbinë Jugore është edhe zhvillimi ekonomik ka thënë Milan Marković. Ai me kryetarin e komunës s Medvegjës Slobodan Draskovićin ka biseduar edhe rreth xeherores së privatizuar „LEQE” në Medvegjë dhe paralajmëroi hapjen e 200 vendeve të reja të punës në këtë xeherore deri në fund të këtij viti. Gjatë ditës, kryetari i Trupit Koordinues ka pasur takime edhe me kryetarët e komunave të Preshevës dhe Bujanocit, Shaip Kamberin dhe Nadër Sadikun si dhe me deputetin popullorë Riza Halimin.
- **Kryetari i posaemëruar i Trupit Koordinues, ministri i pushtetit lokal, Milan Marković, më 5 shtatorë vizitoi komunën e Bujanocit.** Ministri Marković në Bujanoc u takua me kryetarët e komunave të Bujanocit, Shaip Kamberi, Preshevës, Nadër Sadiku dhe të Medvegjës Slobodan Draskovićin. Ai



## Република Србија

### Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

---

gjithashtu pati takim të përbashkët edhe me shefin e OSBE-së në Sërbi, ambasadorin Hans Ola Urstad dhe deputetin popullorë Riza Halimi. Gjatë takimit, Milan Marković së pari falënderoi kryetarët e mëparshëm të Trupit Koordinues, Nebojsa Qoviqin dhe Rasim Lajiqin duke falënderuar kontributin e tyre në përmirësimin e situatës së përgjithshme në këto tri komuna në Jug të Sërbisë. Marković gjithashtu potencoi se ka ende probleme të cilat duhet zgjidhur urgjentisht. "Përgjegjësia para së gjithash më takon mua si kryetarë i Trupit Koordinues për Sërbinë Jugore por edhe kryetarëve të tri komunave. Vetëm me bashkëpunim të ndërsjellë kemi gjasa të arrijmë deri te suksesi të cilin të gjithë e dëshirojmë, jetën më kualitative si dhe hapjen e vendeve të reja të opunës për qytetarët që jetojnë në këtë trevë" ka deklaruar Kryetari i Trupit Koordinues, Milan Marković në konferencën e përbashkët për gazetarë të Trupit Koordinues dhe OSBE-së e cila është mbajtur në Press Qendrën në Bujanoc pas takimeve me kryetarët e të tri komunave. Ambasadori i OSBE-së në Sërbi, Hans Ola Urstad, gjatë konferencës vlerësoi shumë pozitive vizitën e Milan Markovićit në këto tri komuna në Sërbinë Jugore menjëherë pas marrjes së postit si ministër i pushtetit lokal.

Kryetarët e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë përsëritën emërimin e ministrit Milan Marković për Kryetarë të Trupit Koordinues nga i cili presin punë intenzive në zgjidhjen e problemeve.

Në orët e pasditës Marković ka pasur takime të ndara me përfaqësuesit dhe udhëheqësit të partive politike serbe, rome dhe shqipëtare.

- **Strategjia e punës së Trupit Koordinues 2008-2010** – Ekipi i ekspertëve të Trupit Koordinues, ka përfunduar verzionin e punës për periudhën 2008-2010 dhe dorëzoi në adresat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës duke i përfshirë këtu edhe partitë politike më relevante, organizatat joqeveritare, mediat si dhe strukturat tjera komunale. Strategjia është shkruar në bazë të shqyrtimit të marrë nga takimet me përfaqësuesit komunal, partitë politike, sektorit civil dhe shoqërorë, diskutimeve të organizuara në Bujanoc dhe propozimeve në teren. Trupi Koordinues pret komente nga të gjithë akterët relevant të cilëve u është dërguar verzioni i Strategjisë, në bazë të së cilës do të bëhet përmirësimi i kësaj strategjie. Hapi tjetër do të ishte organizimi i një diskutimi publik kurse dokumenti do t'i dorëzohet Qeverisë në verifikim pasiqë të mbërrihet koncenzi i tekstit të Strategjisë.
- Në propozimin e organizatës joqeveritare „Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut, **Nenad Gjurgjeviq, drejtor i i Shërbimit të Trupit Koordinues, është takuar me dymbëdhjetë gazetarë të mediave elektronike dhe botuese nga komunat e Preshevës dhe Bujanocit,** përfshirë këtu RTV ALDI (Preshevë), TV Presheva (Preshevë), RTV Spektri (Bujanoc), RTV Bujanocit (Bujanoc) dhe Perspektiva (Bujanoc). Drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues i informoi përfaqësuesit e mediave mbi punën e Trupit Koordinues, ndërsa njëra ndër tmat ka qenë edhe ringjallja e Press Qendrës në Bujanoc si dhe bashkëpunimi në mes të Trupit Koordinues, medijave dhe organizatave joqeveritare. Kanë rënë në ujdj që tash e tutje bashkëpunimi të jetë më intenziv dhe të mos ket nevojë më të shkohet përmes pushtetit lokal. Përfaqësuesit e mediave munden të lajmërohen në Trupin Koordinues me pyetje dhe sygjerime. Gjithashtu drejtori i Shërbimit shpreh bindjen se përfaqësuesit e mediave do të japin kontributin e tyre në ringjalljen e Press Qendrës.
- **Në bashkëpunim me ministrinë e mbrojtjes së Republikës së Sërbisë dhe komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, Trupi Koordinues do të**



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

**propozoi gjashtë projekte të cilat do të realizoheshin në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës** me ndihmën e ushtrisë së SHBA-ve. Janë propozuar projektet në vijim: rekonstruimi i ambulancës në fshatrat Zhbevc dhe Nesalcë (Bujanoc); rekonstruimi dhe adaptimi i hapësirës i cili do të përdoret si klasë e ndarë e bibliotekës së qytetit në fshatrat Klenik dhe Bilaç (Bujanoc), vendosja e bojlerit si dhe sanimi i gropës septike në shkollën fillore „Radovan Kovačević” në Leqe (Medvegjë); sanimi i shkollës fillore „Zenel Hajdini” në Tupallë (Medvegjë); ndërtimi i qerdhës së fëmijëve në bashkësinë lokale „Stacioni i trenave” (Preshevë); ndërtimi i bunarit dhe zëvendësimi i bojlerit në shkollën fillore „9 Maji” në Relan (Preshevë). Suma e përgjithshme e projekteve të propozuara është 21.190.00 dinarë (407.500 dollarë).

#### Infrastruktura dhe zhvillimi

- Në suaza të programit për forcimin e komunave (MIR2) të cilin e zbaton UNDP-ja e në bashkëpunim me Trupin Koordinues, **është hapur tregu i gjelbërt në Bojnik**. Suma e përgjithshme e punëve të realizuara është 9.6 milion dinarë, nga e cila donatorët e Programit MIR2 siguruan 6 milion dinarë, Qeveria e Republikës së Serbisë përmes Trupit Koordinues finansi 1.9 milion dinarë kurse pjesa tjetër e mbetur 1.7 milion dinarë është finansuar nga buxheti i komunës së Bojnikut.
- Në këtë periudhë, Trupi Koordinues ka bërë edhe hapjen solemne të **fillimit të punës së rrjetit të ujësjellësit në fshatin Konqul, në komunën e Bujanocit**, ndërtimi i së cilës kushtoi 21,4 milion dinarë. Qeveria e Republikës së Serbisë përmes Trupit Koordinues ka finansuar 45% në ndërtimin e këtij rrjeti të ujësjellësit, USAID-i ka finansuar 40% derisa qytetarët e fshatit pjesën tjetër të mbetur 15% të mjeteve. Në hapjen solemne të këtij projekti kanë marrë pjesë drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues Nenad Gjurgjeviq, drejtori i USAID-it në Serbi Majkëll Harvi dhe kryetari i mëparshëm i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi.
- **Është kryer rrjeti primarë i ujësjellësit regional Krshevicë-Klinoc** në bazë të kontratës së nënshkruar me Institutin Jaroslav Qerni dhe mjeteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Serbisë më 27 dhjetorë 2007. në muajt e ardhshëm do të sigurohet edhe rrjeti sekundar i kanalizimit e cila do të sigurojë ardhjen e ujit deri në shtëpitë e banorëve të këtyre fshatrave.
- **Zyrtarët komunal nga Bujanoci dhe Medvegja sertifikohen për tërheqjen e investicioneve në lokal** – Trupi Koordinues, duke i falënderuar Agjencionit për promovim të eksportit dhe investimeve të jashtme (SIEPA) ka përfshirë nëpunësit komunal nga Bujanoci dhe Medvegja në Program të stërvitjes regjionale në promovim për investim e cila finansohet nga BE përmes Agjencionit Evropian për Rekonstruim (EAR) e implementuar nga FIAS- Shërbimi konsultativ i Bankës botërore dhe IFC për përparimin e investimeve. Serbija kështu përfitoi gjeneratën e parë e trajnerëve të specializuar për investime të reja në nivelin lokal. Qëllimi i këtij programi ishte që në mënyrë sa më praktike dhe në mënyrë sa më konkrete të forcohet kapaciteti i organeve lokale dhe të përparojë në konkurimin e komunave për tërheqjen e investimeve të jashtme. Programi i stërvitjes. Posaqërisht ka qenë i fokusuar në të kuptuarit e prioriteteve dhe mënyrës së sjelljes së vendimit mbi investime, analizën e pozicionit të komunës në krahasim me potencialet investive në vend dhe jasht vendit, zhvillimi i

Тел: 017 654 601; 011 21 20 906

Факс: 017 654 604; 011 2

e-mail: [office@kt.sr.g](mailto:office@kt.sr.g)

[www.kt.sr.gov.yu](http://www.kt.sr.gov.yu)

“Ky është prezentimi im i parë në jetën time! Kjo është një përvojë e madhe për mua”, ka deklaruar përfaqësuesi i komunës së Bujanocit, Ismail Pajaziti pas prezentimit të potencialeve ekonomike të Bujanocit e cila është organizuar nga ana MEGA projektit të USAID-t të inicuar nga ana e Trupit Koordinues



## Република Србија

### Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

strategjisë së komunës dhe planit akcional për tërheqjen e investimeve si dhe teknikat primare rreth marketingut. Programin e stërvitjes me sukses e kanë kaluar 40 pjesëtarë nga 29 komunat e Republikës së Serbisë, tri agjensioneve regjionale dhe dy organizatave joqeveritare.

- Pas stërvitjes për marketing dhe promovimin të cilën e zbatoi Banka Botërore/Shërbimi konsultativ për investime të jashtme (FIAS) në bashkëpunim me agjencionin për investime dhe promovim të jashtëm të eksportit (SIEPA), Trupi Koordinues në bashkëpunim me Programin për zhvillimin ekonomik të komunave (MEGA) të cilin finanson Agjensioni Amerikan për zhvillim ndërkombëtarë (ASAID) ka organizuar **stërvitjen shtesë në mënyrë që përfaqësuesit nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja edhe më tepër të aftësohen në prezentimin e potencialeve** të veta ekonomike për investitorët dhe ministritë relevante të Qeverisë së Serbisë. Në këtë stërvitje, përfaqësuesit e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjeskanë pasur rastin që ekspertëve për zhvillim ekonomik lokal si dhe kolegëve të tyre, përfaqësuesve të Kragujevcit dhe Lloznicës t'i prezantojnë prezentimet e tyre për investitorë. Qëllimi i stërvitjes ka qenë përmes njerëzve që kanë praksë të mjaftueshme në tërheqjen e investitorëve të vendit dhe të huaj për investime në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në bazë të komenteve të mara, komunat do t'i kryejnë prezentimet e tyre në periudhën e ardhshme kur do të organizohet edhe një takim ku do të finalizohen prezentimet. Kjo është një ndër aktivitetet e Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë kundrejt rritjes së kapaciteteve të komunave në përfitim të investitorëve në konkurrencë me pushtetet tjera lokale në regjion.
- Shërbimi i Trupit Koordinues organizoi **takim me kryetarin e Medvegjes, Sllobodan Drashkoviçin, me drejtorin e Aliansës Nacionale për Zhvillim Ekonomik Lokal (NALED), Violeta Jovanoviç si dhe me përfaqësuesit e Bankës Komerciale** për të shqyrtuar aktivitetet e përbashkëta në zhvillimin sa më të shpejt të këtij regjioni. Në takim është mar vendimi i vizitës së disa sipërmarrësve më të mirë të NALED-it siq janë Predrag Mihajloviç (Banka Komerciale), Toplica Spasojeviç (ITM) ose Dejan Cvetkoviç (Microsoft) nga Serbia Jugore si dhe takimi me përfaqësuesit komunave dhe me përfaqësuesit e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Qëllimi i kësaj vizite është integrimi ekonomik i këtyre komunave të pazhvilluara në rrjedhat ekonomike të Serbisë.
- Nën iniciativën e Trupit Koordinues, e në zvogëlimin e papunësisë së femrave në komunën e Medvegjes, është organizuar **vizita e përfaqësuesve të ETNO rritit** kësaj komune dhe takimi me kryetarin e komunës, Agjencionin Turistik të Medvegjes si dhe me gratë të cilat merren me punimet tradicionale të dorës nga kjo anë. Përfundimi i këtij takimi është se duhet ndihmuar femrave të cilat kanë marrë vendim të meren me punimet e dorës për treg, në atë mënyrë që të bëhet edukimi në teknikën së përpunimit, pajisjet për prodhim, formimin e asortimanit, standardizimin si dhe shfrytëzimin e motiveve tradicionale në punimet e dorës. Përmes edukimit në këtë degë, frekuentuesit do të formojnë asortimentet, para së gjithash suvenire të cilat në fillim do të plasoheshin në tregun lokal, në Banjën e Sijarinës në suazë të sezonit turistik të ofertës së komunës së Medvegjes, e pas kësaj kujdes do t'i kushtohet pushtimi i tregut më të gjerë. Trupi



Република Србија  
Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

Koordinues ka marrë propozim projektin nga ETNO rrjeta dhe intenzivisht është në kërkim të donatorit i cili do të financoj këtë projekt.

Bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare:

- Trupi Koordinues posaqërisht potencon bashkëpunimin kontinuel me SCC Projektin për meditacionin integrativ (CSSP). **Milan Marković, kryetari i Trupit Koordinues më 29 gusht të vitit 2008 është takuar me kryetarin e CSSP-së Dr. Shvarc Shilingun**, Dr. Huan Armando Dijazin, kryetarin e Këshillit Drejtues dhe Dr. Ditër Volkovićin kryeshefin për zhvillim. Ministri Marković deklaroi se „egziston vetëdije më e lartë rreth dialogut si mekanizëm për zgjidhjen e problemeve”. Ministri Marković potencoi edhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit shqipëtarë në jetën politike të Serbisë. Dr. Kristijan Shvarc-Shiling, i cili ka qenë përfaqësues i lartë në Bosnë dhe Hercegovinë ka shprehur kënaqësi që është takuar me ministrin Marković në kohën e emërimit të tij si kryetarë i Trupit Koordinues. Ai ka falënderuar mundin që po jep Trupi Koordinues mbi përpunimin e strategjisë së re e njëherit ka ofruar ndihmën e tij teknike e cila është e bazuar në praktikën dhe eksperiencën e gjatë të kësaj organizate. Dr. Huan Armando Dijaz, kryetari i Këshillit Drejtues e lajmëroi ministrin Marković rreth principeve të punës së CSSP-së, i cili do të implementohet në priudhën 2008-2009. Qëllimi i këtij projekti është bashkëpunimi dhe aftësimi i liderëve të këtyre tri komunave në përshtatjen e veprimeve për meditim.  
Bashkëpunimi në mes të Trupit Koordinues dhe CSSP-së është formalizuar përmes Memorandumit të mirëkuptimit (MoR) të nënshkruar në shtatorë të vitit 2007. Trupi Koordinues vlerëson dhe falënderon përpjekjet e CSSP-së të dhëna në regjionin e Serbisë Jugore e njëherit ka mendim pozitiv rreth bashkëpunimit me CSSP-në.
- Duke i falënderuar bashkëpunimit të shkëlqyeshëm me Agjensionin Amerikan për zhvillim ndërkombëtarë (USAID), Trupi Koordinues është angazhuar në **përfshirjen e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në Programin e zhvillimit të komunave (MEGA)**. Kjo është posaqërishtë me rëndësi se përfshirja në këtë program nënkupton edhe formimin i zyreve komunale për zhvillim ekonomik, revizionin e Planeve Strategjike dhe përpunimin e Planeve Akcionale me projekte saktësisht të definuara të cilat në periudhë më të gjatë kohore do të ndihmonin në zhvillimin ekonomik të komunave si dhe implementimin e disa problemeve të definuara të projekteve ekonomike. Gjithashtu sfera e cila është identifikuar si problematike nga Trupi Koordinues dhe e cila mundet të zgjidhet me ndihmën e MEGA programit është edhe aftësimi i kuadrove në kërkim të kreditimit të komunave.
- Trupi Koordinues gjithashtu ka arritur që komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës t'i përfshijë në **programin „transferimi i njohurive të nënpunësve komunal të Serbisë në sferën TQM (Total Quality Management) sistem në udhëheqjen e administratës komunale” të cilën e financoj Ambasada Hungareze në Beograd**. Ky sistem i kyq administratat komunale në kornizën e bashkimit European e njëherit është prezantimi i parë i këtij lloji në Serbi. Suksesi është edhe më i madh kur merret parasysh se Presheva, Bujanoci dhe Medvegja janë komunat e vetme të cilat janë përfshirë në këtë lloj arsimimi me vetëm gjashtë qytete të Serbisë duke përfshirë këtu Beogradin,





Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

---

Kragujevcin, Nishin, Novi Pazarin, Novi Sadin dhe Suboticën. Fillimi zyrtar i këtij programi pritet të jetë nga fundi i tetorit të vitit 2008. ky lloj trajnimi do t'i mundësojë zyrtarëve komunal nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të mësojnë disa metoda të reja në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve si dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së tyre.

- **Kredija për gazetarët e Dart qendrës për gazetari dhe trauma** – Duke i falënderuar programit USAID mbështetjes së mediave, të cilën zbaton IREX, Trupi Koordinues ka përcjellur informatat mbi kreditimin e gazetarëve të gjithë mediave në Jug të Sërbisë. Qëllimi i Dart Qendrës që të aftësojnë grupet e gazetarëve që në mënyrë profesionale dhe me përgjegjësi të informojnë mbi dhunën dhe problemet dramatike duke përfshirë edhe kriminalitetin, dhunën në familje, fatkeqësitë natyrore, luftën dhe gjenocidin.
- **Takimi me grupin e 11 studentëve të Univerzitetit të Bristolit, Britani e Madhe, pjesëtarë të Shoqërisë për marrëdhënie ndërkombëtare** – Me kërkesë të anëtarëve të Shoqërisë për marrëdhënie ndërkombëtare të Univerzitetit të Bristolit, drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues është takuar me grupin e studentëve të cilët kanë qenë në udhëtim studjor në Sërbë. Temat e takimit kanë qenë aktivitetet e Trupit Koordinues, situata në Sërbinë Jugore dhe marrëdhëniet ndëretnike. Grupi i studentëve në përgjithësi ka qenë i përbërë nga studentët e marrëdhënieve ndërkombëtare, zhvillimit ndërkombëtarë, të drejtës ndërkombëtare, historisë së BE. Udhëtimet e tyre studjuese të mëparshme kanë përfshirë Moskën, Nju Jorkun, Uashingtonin, Gjenevën, Parisin dhe Brukselin.

*Qëllimi i Trupit Koordinues është që përmes partneritetit me Ministritë tjera të Qeverisë së Republikës së Sërbisë, organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e shteteve të huaja të kontribuojnë në zhvillimin e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Trupi Koordinues bënë përpjekje në përparimin e kapaciteteve të bashkësive lokale dhe bashkësive civile që ato në mënyrë të pamvarur të mbështeten në zhvillimin ekonomik, pa u mbështetur në ndihmat afatëshkurtëra nga të cilat ndihma situata nuk do të përmirësohet në një afat më të gjatë kohorë dhe e cila nuk kontribuon në zvogëlimin e varfërisë të këtyre komunave.*